



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

### PROCESVERBAL

Tiranë, më 16.04.2019, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja – kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

Seancë dëgjimore për raportimin vjetor të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2018. *(Komision përgjegjës)*

#### **Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Edmond Leka, Alket Hyseni, Spartak Braho, Alban Zeneli, Koral Lita, Aurora Mara, Elena Xhina dhe Adriatik Alimadhi

#### **Mungojnë:**

Klotilda Bushka, Damian Gjiknuri, Jurgis Çyrbja, Elda Hoti dhe Tom Doshi

#### **Të ftuar:**

Pranvera Strakosha – Komisionere për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil

Arbana Basha - Drejtore e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit në Institucionin e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil

Enkelejda Hebibasi - Drejtore e Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë në Institucionin e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil

Altin Shumeli - Drejtor i Mbikëqyrjes Jashtë në Institucionin e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil

Ollga Hodaj - Drejtore e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse në Institucionin e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil

## HAPET MBLEDHJA

**Ulsi Manja** – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme. Sot kemi seancë dëgjimore me Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për raportuar aktivitetin e punës së komisionerit për vitin 2018. Këtë seancë dëgjimore Komisioni i Ligjeve e zhvillon në kuadrin e kontrollit parlamentar me institucionet kushtuese dhe të pavarura që janë në sferën e përgjegjësisë së komisionit. Në komisionin tonë raportojnë rreth 16 institucione të pavarura dhe të krijuara me ligj, sot e ka radhën Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Dua të sjell në vëmendjen e kolegëve të komisionit që ne këtë vit kemi realizuar edhe një vizitë studimore në ambientet ku ushtron veprimtarinë Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe jemi njohur nga afër me problematikat e punës së këtij institucioni, pra le të themi një ditë pune e zakonshme në institucionin që drejton zonja Strakosha, ndërsa sot jemi raportimin e veprimtarisë së komisionerit për gjithë vitin 2018. Si zakonisht do të ketë edhe një rezolutë të Kuvendit për Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për detyrat që do t'i lërë Kuvendi për vitin që vjen.

Zonja Strakosha, do t'ju lutesha të na raportoni sot rreth përmbushjes së detyrave të lëna në rezolutën e Kuvendit, sepse me materialin që ju sjellë kolegët janë njohur paraprakisht, një material i plotë dhe voluminoz, më pas kolegët të kenë kohën e mjaftueshme për pyetje dhe diskutime për veprimtarinë e institucionit që ju drejtoni.

Mirë se erdhët në komision, zonja Strakosha dhe stafi që ju shoqëron!

Nëse do të jetë e nevojshme për të shtuar diçka, anëtarët e stafit që ju shoqëron, mund të prezantohen.

Pa humbur kohë fjala për ju për të na bërë një përmbledhje të shkurtër të aktivitetit të institucionit që ju drejtoni.

Relator është kolegu Alket Hyseni dhe si përherë komisioni ynë është komision përgjegjës për raportimet e institucioneve që janë në fushën e përgjegjësisë së komisionit.

**Pranvera Strakosha** – Faleminderit!

I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Është kënaqësi të raportoj para jush për veprimtarinë e institucionit që unë drejtoj për vitin 2018. Komisioneri gjatë vitit 2018 ka vijuar veprimtarinë e tij në zbatim të kompetencave dhe sipas kërkesave dhe rekomandimeve të lëna në rezolutën e Kuvendit “Për miratimin e veprimtarisë për vitin 2017”. Prioritet i veprimtarisë gjatë këtij viti kanë qenë rekomandimet e rezolutës, të cilat janë zbatuar plotësisht, me përjashtim të rekomandimit për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për të cilin, në fakt, faza e parë ka mbaruar plotësisht. Ky ishte një rekomandim që përmbante disa faza dhe tashmë gjatë këtij viti jemi në fazën e dytë të tij gjë, të cilën do t’jua shpjegoj më poshtë.

Pa dashur të zgjaten, pasi gjithë veprimtarinë e institucionit që unë drejtoj, punën dhe problematikat ne jua kemi shprehur në raport dhe në përmbledhjen që i kemi dërguar Kuvendin, dua të tërheq vëmendjen tuaj vetëm për disa momente kryesore.

Sa u takon gjetjeve dhe problematikave, fenomeni i zbatimit të kontratës së punës për pozicionet e shërbimit civil, megjithëse është kufizuar ndjeshëm, është ende evident. Gjatë këtij viti janë mbikëqyrur 1592 pozicione pune, nga të cilat janë evidentuar 357 raste ose 22% të tyre si emërimet të paligjshme në kundërshtim me ligjin, nga të cilat 57 raste të administratës shtetërore dhe 300 raste të pushtetit vendor. Nga mbikëqyrja konstatohet se zbatimi i legjislacionit të shërbimit civil në nivel lokal mbetet ende në nivelin bazë, megjithëse mund të identifikohen praktika të mira dhe premtuese në disa prej bashkive, kryesisht bashkitë e mëdha.

Numri i stafit të burimeve njerëzore në bashki dhe kapacitetet e tyre janë të kufizuara. Ekziston tendenca e përgjithshme për të kufizuar fushën e zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil për sa më pak të jetë e mundur nga stafi i bashkisë. Veçanërisht ekziston një tendencë për të shmangur zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil nëpërmjet krijimit të njësive organizative jashtë fushës së veprimit të ligjit për shërbimin civil.

Strukturat e administratës së bashkisë përfshihen nga ndryshime të shpeshta, të pajustificuara, në përgjithësi me shtim të pozicioneve të punës, në disa raste edhe brenda një viti, gjë që ndikon seriozisht në procesin e përgatitjes të përshkrimit të vendeve të punës ose zbatimin e duhur të legjislacionit të shërbimit civil. Zbatimi i procedurave të përshtatshme konkurruese të rekrutimit ose promovimit nuk janë në nivelin e duhur, pasi ende evidentohen raste ku në bashki nuk kryhet rekrutimi në nivelin hyrës, pra niveli ekzekutiv, ashtu siç kërkohet nga legjislacioni.

Përgatitja e përshkrimit të punës për shumicën e pozicioneve është në një fazë fillestare, me gjithë përpjekjet që janë bërë gjë që duhen vlerësuar, për të hartuar formalisht dokumentin.

Konstatohen raste ku përshkrimet e punës për shumë pozicione nuk janë përgatitur ose janë të një cilësie të ulët. Komisioneri vlerëson se mjetet në dispozicion të zbatimit të ligjit, sidomos në disa prej instituteve të tij mungojnë ose janë të pakta, janë të ndërlikuara dhe jo të lidhura me kontekstin e administratës vendore. Në këto kushte komisioneri vlerëson se ka lindur nevoja për një legjislacion të ri të posaçëm për organizimin e administratës vendore, si dhe për të rishikuar dhe zgjeruar gamën e mjeteve që ka në dispozicion stafi i menaxhimit të burimeve njerëzore për zbatimin e ligjit.

Në drejtim të dokumentimit të dokumentit të përshkrimit të punës komisioneri ka konstatuar probleme edhe në institucionet e varësisë të administratës shtetërore, në të cilat ndryshe nga njësitë e qeverisjes vendore, janë efektive mjetet për zbatimin e ligjit. Aktet që materializojnë përshkrimin e punës në këto institucione kanë nevojë të menjëhershme për rinovim në lidhje me funksionet, detyrat, objektivat, kërkesat e veçanta të vendit të punës e të tjera. Departamenti i Administratës Publike duhet të luajë një rol aktiv në këtë rast, në kushtet e njësisë përgjegjëse për të orientuar dhe mbështetur me trajnime menaxherët e ngarkuar nga ligji për këtë detyrë.

Përgjatë vitit 2018, ka vijuar procesi i mbikëqyrjes në vazhdim në lidhje me verifikimin e zbatimit të vendimeve të komisionerit në 49 institucione. Komisioneri ka konstatuar dhe subjektet i kanë zbatuar vullnetarisht vendimet paralajmëruese si në rastin e mbikëqyrjes, edhe të inspektimeve, ashtu edhe të vendimeve individuale për zgjidhjen e ankesave të ardhura pranë komisionerit. Në këto kushte nuk ka qenë e nevojshme që ne të aplikojmë gjobën ndaj personit përgjegjës ashtu siç parashikohet në nenin 15 të ligjit.

Në disa raste, të cilat u përkasin institucioneve të administratës vendore, komisioneri ka vlerësuar që procesi i rregullimit të situatës të ndahet në faza, duke marrë parasysh specifikat dhe rrethanat konkrete në të cilat zhvillohet administrimi i shërbimit civil në këto subjekte, sipas një plani veprimi të caktuar me afate të përcaktuara. Kjo ka ndodhur për faktin se ne kemi konstatuar në pushtetin vendor rreth 80% të rasteve të emëruara në kundërshtim me ligjin dhe konstatim të pavlefshmërisë absolute të akteve, i njëkohshëm, do të pezullonte dhe bllokonte veprimtarinë e institucionit. Për të gjitha këto arsye ne kemi rënë dakord që ky proces të zhvillohet në faza, edhe për faktin se një procedurë konkurrimi me të gjitha afatet e ankimit kërkon një periudhë rreth 2 muaj.

Gjatë këtij viti ka përfunduar kontrolli në 61 njësi të qeverisjes vendore, i cili ka nisur 3 vjet më parë. Ne kemi kërkuar në përfundim të këtyre kontrolleve, pasi ka pasur 1207 raste,

anulimin e emërimeve në kundërshtim me ligjin. Nga këto në 740 raste ose 61% të tyre, situata është rregulluar, në 437 raste ose 39% vijon procesi për rikthimin e gjendjes së ligjshmërisë për shkak të fazave në të cilat ne e kemi ndarë këtë proces.

Veç kësaj gjatë vitit 2018 është punuar në drejtim të administrimit të të dhënave dhe studimit të situatës në lidhje me nivelin e zbatimit të ligjit në fushën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, një detyrë shumë e rëndësishme që na u la edhe në rezolutën e Kuvendit. Janë mbledhur të dhënat nga 112 institucione dhe në përfundim janë evidentuar 311 vendime të formës së prerë, që janë ende të paekzekutuara, nga të cilat 209 raste ose 67% e totalit i përkasin administratës shtetërore, 90 raste njësive të qeverisjes vendore dhe 12 raste institucioneve të pavarura.

Thjesht sa për të pasur një ide, nga viti 2014 deri në vitin 2018 janë ankimuar në gjykatë 970 raste, janë përfunduar me vendim përfundimtar 629, nga të cilat 152 rrëzim i padisë dhe 477 është pranimi i padisë dhe janë duke u gjykuar ende 341 raste. Nga 477 raste me vendim përfundimtar të formës së prerë kanë mbetur pa u ekzekutuar vetëm 311. Aktualisht, jemi në fazën e dytë të ekzekutimit të vendimeve, por paraprakisht kemi konstatuar edhe momente midis shumë arsyeve subjektive, por ka edhe arsye objektive pse nuk kanë arritur të zbatohen vendimet e formës së prerë.

Nga ndryshimet ligjore që iu bënë ligjit, unë e kam thënë edhe herë tjetër, në bazë të nenit 66/1 theksohet që vendimet gjyqësore të formës së prerë ekzekutohen të detyrueshme, por në qoftë se pozicioni i punës nuk ekziston më atëherë gjyqfituesit i ofrohet një pozicion tjetër ekuivalente me të parin. Gjithashtu, vlerësohen edhe kërkesat e vendit të punës dhe kushtet që ka gjyqfituesi, i cili është i papunë, por ndërkohë merr pagë. Ka pasur raste kur atij që i ka fituar gjyqin i janë ofruar disa pozicione ekuivalente, por për shkak se ligji thotë: “Me pëlqimin e tij ai pranon të emërohet në një pozicion tjetër”, kjo ka sjellë pengesa, pasi palët nuk e japin pëlqimin. Ndërkohë, na rezultojnë se këta persona janë të punësuar në pozicione të tjera, jashtë shërbimit, civil dhe marrin dy paga. Këtë gjë ne e kemi konsideruar shkelje, ashtu siç e ka konsideruar shkelje të disiplinës financiare edhe KLSH-ja. Meqenëse tani do të jetë faza e dytë, ne do t’i vlerësojmë dhe do t’i shikojmë rast pas rasti, duke nxjerrë edhe raporte individuale për çdo rast.

Gjatë vitit 2018 është realizuar mbikëqyrja orientuese në lidhje me rekrutimet e DAP-it për plotësimin e 834 pozicioneve të punës me 484 procedura konkurrimi. Ky proces paraqitet transparent dhe brenda kufijve proceduralë.

Komisioneri konstaton konsolidimin e procesit të rekrutimit nga pikëpamja e respektimit të procedurave në administratën shtetërore, ku vihet re: shtimi i numrit të konkurrentëve për një proces rekrutimi; zbatimi i parimit të rekrutimit në grup; zbatimi i parimit të transparencës së procesit; respektimi i të drejtës së ankimit të konkurrentëve, gjë që pasqyrohet në rritjen e numrit të konkurrentëve në fazën pas shqyrtimit të ankesave.

Gjithashtu, është finalizuar procesi i nisur në vitin 2017 për monitorimin e veprimtarisë administrative dhe respektimin e procedurave gjatë ristrukturimit të administratës shtetërore në 11 ministritë e linjës dhe në Kryeministri. Në fakt, në fund të vitit 2017 e gjithë administrata shtetërore qendrore u përfshi në proces ristrukturimi, proces të cilin ne e kemi ndjekur me shumë vëmendje dhe kemi ndjekur çdo procedurë, duke dalë me vendime individuale për çdo ministri.

Në total në proces ristrukturimi u përfshinë 1922 pozicione pune dhe rezultojnë 1723 pozicione pune në shërbimin civil, pas ristrukturimit, pra është pakësuar me 199 pozicione. Në shërbimin civil janë sistemuar 134 nëpunës të nivelit të mesëm, të ulët dhe ekzekutivë, si dhe 54 anëtarë të trupës së nivelit të lartë drejtues. Gjithashtu, janë liruar nga shërbimi civil 50 punonjës, 47 janë transferuar pranë AKSHI-it, në zbatim edhe të VKM-së, si dhe 81 punonjës janë transferuar tek institucionet e varësisë. Ky është i gjithë procesi i ristrukturimit, ku nga 50 punonjës të liruar, 21 prej tyre kanë bërë ankimim në gjykatë dhe ne jemi në pritje të vendimeve gjyqësore.

Komisioneri ka konstatuar se komisionet e ristrukturimit janë ngritur në përputhje me kërkesat specifike të ligjit, me aktet nënligjore, si dhe janë zbatuar afatet procedurale të këtij procesi. Ajo që duhet të evidentohet është fakti se gjatë këtij procesi është punuar me përshkrimet e mëparshme të punës. Pra, ne i kemi konstatuar si mangësi të departamentit, por edhe të ministrive, pasi kanë punuar vetëm me ekstrakte të përshkrimit të vendit të punës dhe nuk janë miratuar formularët e përshkrimit të punës për pozicionet e reja të krijuara. Edhe pse ne i kemi konstatuar si mangësi, kjo nuk e ka cenuar procesin, pasi ekstraktet e përshkrimit të punës ishin ato që kërkoheshin për ato pozicione pune. Këtë gjë ne e kemi kërkuar te çdo raport monitorimi për çdo ministri dhe aktualisht përshkrimet e punës janë të përfunduara. Përveç veprimtarisë së përgjithshme, janë shqyrtuar 105 informacione të ardhura në postën zyrtare të Komisionerit për ankesa, por edhe ato që ne i kemi marrë qoftë nga posta elektronike, qoftë nga mediet, janë verifikuar dhe kemi dalë me vendime përfundimtare. Unë nuk po zgjatem t'i them, pasi shifrat janë të pasqyruara në raport.

Në vendimet paralajmëruese të Komisionerit për vitin 2018 në 671 raste është kërkuar pavlefshmëria absolute e aktit të emërimit, pasi kanë qenë akte në kundërshtim me ligjin dhe është kërkuar rregullimi i gjendjes së ligjshmërisë. Nga këto 463 raste ishin emërime me kontratë, 127 raste ishin deklarime të statusit të punësimit në kundërshti me ligjin dhe 49 raste ishin për mospërbushje të kriterit arsimor, pasi kanë qenë me shkollë të mesme.

Në raport ne kemi paraqitur edhe disa kërkesa në lidhje me ndryshimet ligjore, që ne i kemi konstatuar dhe janë të domosdoshme, pasi kanë lindur si nevojë e zbatimit të ligjit në gjithë këta vjet.

Në nenin 66/1 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” paraqitet problematika që nga kjo dispozitë të hiqet nocioni “dhënia e pëlqimit të nëpunësit”, për emërimin në detyrë, si dhe për zbatimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë, duke e lidhur detyrimin për ekzekutimin e vendimit në kufizimet që përmbajnë dispozitat e neneve 50, 51, 52 të ligjit, të tilla si: kategoria e njëjtë, arsyet shëndetësore, largësia nga vendbanimi, konflikti i interesit e të tjerë.

Në nenin 15, pika 2, që rregullon procesin e mbikëqyrjes, të përkufizohet qartë dhe në mënyrë shteruese koncepti “nëpunës përgjegjës” në lidhje me shkeljet e konstatuara nga Komisioneri, për të shmangur kufizimin e përgjegjësisë të drejtuesit të njësive të qeverisjes vendore apo të institucioneve të pavarura, të cilët në shumicën e rasteve merren posaçërisht dhe drejtpërdrejt me procesin e administrimit të burimeve njerëzore.

Në nenin 62, pika 2, që ka të bëjë me vlerësimin e performancës në punë të nëpunësit civil, ne kemi kërkuar të zgjerohen nivelet e vlerësimit, të cilat aktualisht janë vetëm 4, me qëllim që të rritet objektiviteti i nëpunësit civil nga ana e eprorit direkt.

Gjithashtu, ne kemi kërkuar që të harmonizohet ligji “Për vetëqeverisjen vendore” me kërkesat e ligjit “Për nëpunësin civil, në drejtim të vendosjes së standardeve të qarta për organizimin e burimeve njerëzore dhe funksioneve në administratën vendore; të vlerësohet mundësia për hartimin e një legjislacioni të ri për ndërmarrjet në administratën lokale, me qëllim që të mundësohet ndarja e qartë ndërmjet funksioneve të shërbimit civil dhe atyre që kanë tipare ndihmëse administrative dhe funksione direkte të shërbimit.

Për vitin 2019 ne kemi në fokus dy momente kryesore: monitorimin e sjelljes së nëpunësve civilë gjatë fushatës elektorale të zgjedhjeve vendore qershor 2019, proces që e kemi filluar këto ditë, ashtu siç e kemi bërë në vitin 2017, si dhe do të vazhdojmë me fazën e dytë të ekzekutimeve të vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Strakosha!

Zoti Hyseni e ka fjalën.

**Alket Hyseni** - Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit komisioneres për raportimin!

Bazuar në analizën e raportit vjetor të Komisionerit të bërë nga Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve, bazuar në vizitën që Komisioni për Çështjet Ligjore ka bërë pranë Komisionerit, si dhe bazuar në informacionet e tjera, më lejoni t’i relatoj këtij Kuvendi se Komisioneri përgjithësisht ka respektuar apo ka realizuar rekomandimet e lëna në rezolutën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Në fakt, këto rekomandime kanë qenë të bazuar kryesisht te detyrat që Komisioneri ka në zbatimin e ligjit “Për nëpunësin civil”, në aktet nënligjore ku bazohet kjo veprimtari, por edhe në orientimet e punës që i jep Kuvendi si organi nga i cili varet ky institucion.

Komisioni ynë, sikurse edhe kryetari e citoi, është komision përgjegjës për këtë raportim dhe na takon që të jemi të drejtë dhe të qartë në këto raste, sepse në të kaluarën (sikurse Kryetari i Kuvendit e ka ngritur si shqetësim në takimin e bërë me institucionet e varësisë së Kuvendit), raportimet ose kanë munguar dikur, ose kanë qenë formale. Në vitet e fundit është bërë traditë, ku cilësia e raportimeve është rritur dhe puna është marrë më me seriozitet, por është ende larg asaj që duhet të jetë.

Në këtë këndvështrim, më lejoni që edhe këtë raport ta shikoj me të njëjtin fokus, edhe pse formalisht janë përmbushur 4 nga rekomandimet, si: rekomandimi i procesit mbikëqyrës dhe inspektimit të përgjithshëm; rekomandimi për asistencën teknike të njësive përgjegjëse për zbatimin e ligjit “Për statusin e nëpunësit civil”; rekomandimi për ndjekjen me përparësi dhe verifikimin e zbatimit të vendimeve paralajmëruese nga ana e institucioneve të mbikëqyrura apo të inspektuara, si dhe rekomandimi i mbikëqyrjes së inspektimit të përgjithshëm tematik apo hetimit administrativ për raste individuale, që vlen për t’u diskutuar, pasi puna ka nisur, por është objekt i vitit 2019.

Unë mendoj se dy rekomandime të rëndësishme, të cilat edhe në raport janë pranuar se janë zbatuar pjesërisht, janë: rekomandimi për koordinimin e punës dhe veprimtarisë ndërmjet DAP-it, si njësia përgjegjëse e administratës shtetërore, dhe njësive të menaxhimit të burimeve njerëzore në administratën vendore dhe në institucionet e pavarura, edhe për shkak të shumë

specifikave. Vetë komisionerja e pranon se tek institucionet e pushtetit vendor ka një problematikë të theksuar të zbatimit të ligjit “Për statusin e nëpunësit civil”.

Rekomandimi i dytë është ai i të pasurit në fokusin e veprimtarisë së Komisionerit hetimin administrativ konkret për rastet individuale, për të cilat Komisioneri për 105 ankesat i raporton ato në proces. Megjithatë, më lejoni të ndalem në një rast konkret për të theksuar risitë që ka sjellë ky raport, por edhe shumë vërejtje të nxjerra nga Shërbimi i Monitorimit.

Komisioneri pas vitit 2017 duke qenë se qeveria hyri në një strukturim të thellë dhe nga 16 ministri u ristrukturuan 11. Është nxjerrë një urdhër me nr. 85, datë 09.10. 2017, i cili nuk është publikuar dhe as nuk i është bashkëngjitur raportit për Kuvendin, pra Shërbimit të Monitorimit. Nga ky urdhër ka filluar kontrolli dhe mbikëqyrja e këtij procesi, i cili ka bërë shumë mirë, sepse në këto raste kjo është detyra bazë e Komisionerit.

Raporti është ndarë në 11 raporte për secilën ministri. Shërbimi i Monitorimit ka konstatuar se informacioni në raport është në arrati dhe i përgjithshëm, ai shoqërohet me tabela statistikore, por raportimi është i veçantë për çdo ministri me konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse, struktura e raportit, baza ligjore, qëllimi i monitorimit, metodologjia, përmbajtja e raportit, konkluzionet dhe masat e rekomanduara rezultojnë të njëjta në 11 raportet.

Komisioni ka dhënë disa rekomandime të vlefshme për sa i takon hartimit të përshkrimit të punës, sipas formateve përkatëse të vendimit të Këshillit të Ministrave, pra të akteve nënligjore, gjë që është konstatuar në mangësi, dhe disa rekomandime të tjera.

Çfarë problematikash janë konstatuar në 11 raportet? Nuk jepen afate se kur ka filluar dhe përfunduar monitorimi nga Komisioneri, për më tepër që nga data e daljes së urdhrit, monitorimi ka filluar katër muaj me vonesë, arsyen nuk e dimë.

Procesi i vlerësimit nëpërmjet pikëzimit, çështje që Shërbimi i Monitorimit e ngriti edhe gjatë takimit, çalon në mënyrë të ndjeshme, sepse nuk jepen detaje se si është aplikuar procesi i vlerësimeve, pra ai i pikësimit, bazuar në akte nënligjore dhe urdhrin konkret të Departamentit të Administratës Publike. Kemi thënë se vlerësimi është proces i rëndësishëm, sepse nga ky proces nuk lind vetëm pasqyrimi i mangësive në punën e nëpunësve të administratës, por lind edhe detyrimi i administratës për ta trajnuar këtë nëpunës, për ta bërë të aftë në ato sektorë ku ai ka deficienca.

Në procesin e ristrukturimit me rëndësi është efekti i burimeve njerëzore, duke pasur si qëllim ripozicionimin e kapaciteteve njerëzore, për të cilat është investuar në këto trajnime që unë

citova, në pozicionet e reja, të cilat duhet të jenë sa rezultative dhe në përputhje me kualifikimet e përvojën, mbajtjen në konsideratë të minimizimit të impakteve negative, gjë që nuk del përgjithësisht.

Në vendimin e Komisionerit nuk referohen shkelje, por thjesht parregullsi. Pra, sipas Shërbimit të Monitorimit përdoren terma zbutës.

Gjatë analizës për secilën ministri në pjesën përshkruese, arsyetuese dhe rekomanduese, megjithëse raportohen problematika, nuk referohen persona përgjegjës. Edhe pse Komisioneri ngriti nevojën për përmirësime ligjore, duke përkufizuar qartë termin “person përgjegjës”, është detyrë e Komisionerit të konstatojë personat përgjegjës me aq sa përshkruan legjislacioni konkret.

Komisioneri justifikon se mospërmbushja e detyrimeve ligjore gjatë procesit të ristrukturimit ka qenë për shkaqe emergjence, ndërkohë që ligji nuk parashikon hapësira për situata emergjente, por për zbatim korrekt të dispozitave ligjore.

Nuk është analizuar moszbatimi i udhëzimeve të DAP-it dhe vendimeve të Këshillit të Ministrave përkatëse për përshkrimin e punës, sikurse unë përmenda më lart te raportet përkatëse, pra te mangësia në raporte.

Nuk janë evidentuar roli dhe as veprimet detyruese që DAP-i duhet të ndërmernte si organ kyç e përgjegjës së bashku me aktorë të tjerë, që parashikon ligji në procesin e ristrukturimit.

Në vlerësimin e Shërbimit të Monitorimit të Kuvendit, Komisioneri nuk ka kryer një mbikëqyrje dhe një analizë të mirëfilltë të zbatimit të instituteve të shërbimit civil, edhe pse është fokusuar në disa prej tyre, si për shembull, procesi i ristrukturimit, dhe mënyrën se si duhet të veprojnë organet përgjegjëse në rastet e konstatuara me problematikë.

Struktura përgjegjëse që ligji e ngarkon me përgjegjësi, pra burimet njerëzore, nuk e kanë menaxhuar si duhet këtë proces. Besoj se këta kanë qenë të evidentueshëm, sepse ky ka qenë edhe synimi kryesor i raportit.

Sipas arsyetimit të Komisionerit, eprorët ende nuk kishin filluar punë, por një udhëzim nga DAP-i ngarkon burimet njerëzore ekzistuese së bashku me sekretarët e përgjithshëm apo një epror tjetër të konceptojnë formularët përkatës të përshkrimit të punës.

Ana pozitive ka qenë konstatimi se tashmë administrata është konsoliduar dhe numri i ankesave apo i personave që preken me pa të drejtë në shkelje të ligjit, në ato që Komisioneri i quan parregullsi, ndërkohë që në thelb mund të jenë shkelje të ligjit, është i vogël në krahasim me të kaluarën. Komisioneri referoi se nga 1723 nëpunës të futur në proces ristrukturimi, vetëm 21

nëpunës i janë drejtuar gjykatës. Në aspektin e administratës kjo është për t'u vlerësuar, por pa e shmangur faktin që ka mangësi në raport jo vetëm për 21 ankesat në gjykatë, por edhe për 50 rastet e tjera, të cilat kanë pasur problematika në lidhje me lëvizjen, ku një pjesë janë sistemuar, për të cilët duhet të ishin nxjerrë personat përgjegjës.

Hartimi në kohë i formularëve të përshkrimit të punës është pjesë e garancisë ligjore në procedurën e ristrukturimit, sepse, nëse ristrukturimi kryhet pa u bazuar në atë çfarë përfaqëson vendi i punës dhe nëpunësi që do të vendoset në atë vend pune, atëherë mendojmë që lë vend për shumë diskutime.

Megjithatë, Shërbimi i Monitorimit ka rezervuar të drejtën që edhe mbas këtij raportimi të listojë më vonë një sërë rekomandimesh për veprimtarinë e Komisionerit për vitin 2019, rekomandime të cilat do të përcillen në rezolutën e ardhshme të Kuvendit, e cila do të diskutohet këtu dhe do të marrim vërejtje dhe sugjerime nga të gjithë kolegët e komisionit. Do ta konsultojmë edhe me Komisionerin në mënyrë që të realizojmë një rezolutë, e cila do t'i shërbejë qëllimit të Komisionerit dhe shpresojmë që në raportimin periodik, jo atë të vitit që vjen, gjatë këtij viti të kemi reflektime edhe të problematikave të hasura vitin e kaluar.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Hyseni!

Zonja Strakosha, pasi kolegët do të bëjnë pyetje, ju mund të përgjigjeni jo vetëm për pyetjet, por edhe për problematikën, sepse replikën nuk e kemi me Kuvendin, me Komisionin e Ligjeve dhe as me relatorin.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Mund t'i sqarosh kur të përgjigjesh për pyetjet që do të bëjnë kolegët, por gjetjet e relatorit janë mbi bazën e raportit që keni sjellë ju. Pra, asgjë nuk ka dalë jashtë këtij raporti.

A ka pyetje nga kolegët?

Fjalën e ka zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zonja komisionere për raportin!

Këtë vit raporti juaj ka qenë i detajuar dhe jep përgjigje për një sërë rekomandimesh që janë paraqitur në rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë për institucionin tuaj.

Ju ndoqa me vëmendje gjatë raportimit, njëkohësisht kam lexuar raportin dhe analizën që ka bërë sektori i Shërbimit të Monitorimit të Institucioneve të Pavarura. Unë kam një pyetje në

lidhje me konstatimet që ju përmendët dy herë, për nevojën e ndryshimit të legjislacionit, që rregullon mënyrën e marrjes në punë të punonjësve në administratën vendore, ku edhe unë ndaj të njëjtin mendim me ju dhe e quaj të drejtë. Në vlerësimin tuaj, nga inspektimet që janë bërë, a keni konstatuar që ligji i nëpunësit civil nuk zbatohet, por edhe kur zbatohet, ligji nuk është i përshtatshëm për njësitë e vetëqeverisjes vendore? Nëse ju keni konstatuar një gjë të tillë, a keni ndonjë sugjerim konkret për të amenduar ligjin e vetëqeverisjes, sepse në relacion dhe raport thuhet: “Ka nevojë të afrohet” apo ka nevojë të rritet trajnimi i drejtorive të Burimeve Njerëzore, pra të ketë një manual praktik të zbatimit të ligjit? E para.

E dyta, ju e keni ngritur disa herë dhe keni qenë shumë konsistente lidhur me zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe sugjeroni që në ligjin “Për nëpunësin civil” të hiqet togfjalëshi “dhënia e pëlqimit të nëpunësit”. Në vlerësimin tuaj, nga inspektimet dhe studimi i rasteve keni konstatuar që DAP-i u ka ofruar mundësi për pozicione pune dhe ata nuk kanë pranuar? Këtë mospranim e keni gjetur në kundërshtim me kërkesat që thotë ligji, si: distanca, përshtatja, niveli e të tjera, apo keni konstatuar që ky ligj nuk është zbatuar nga personat që iu është ofruar vendi i punës, sepse, siç e thatë edhe ju, kanë dashur të përfitojnë pagën, deri sa të sistemohen, dhe pagesën që marrin nga punësimi në një institucion tjetër. Mua më duket skandaloze që një punonjës është në punë, pavarësisht se nuk është në shërbimin civil, por paguhet me fondet e buxhetit të shtetit, dhe nga ana tjetër të vazhdojë të marrë pagesë. Në vlerësimin tuaj, a ka ndonjë mangësi apo vakum ligjor që DAP-i nuk arrin ta kontrollojë apo ta vlerësojë mundësinë e punësimit të këtyre personave, që ndërkohë kanë një vendim gjyqësor të formës së prerë? Ka ndonjë mungesë regjistri apo mendoni se Kuvendi i Shqipërisë duhet të ndërmarrë ndonjë nismë për të amenduar ligjin ose për të forcuar kontrollin parlamentar për zbatimin e tij?

E fundit, ju vazhdimisht keni ngritur problemet e njësive të qeverisjes vendore dhe shumica e punësimeve janë në nivel vendor. Keni një analizë të detajuar të njësive të qeverisjes vendore dhe sugjeroni ju ndonjë masë përgjegjësie individuale për këto shkelje flagrante që i bëhen ligjit, të cilat kanë edhe një kosto financiare në buxhetin e shtetit?

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Hysi!

Fjalën e ka zonja Strakosha.

**Pranvera Strakosha** – Së pari, nevoja e ndryshimit të legjislacionit në administratën vendore ka lidhje me standardizimin e strukturave. Vitin e kaluar ne nxorëm një udhëzim pasi në

njësitë e qeverisjes vendore, në një bashki, konstatuam që në shërbimin civil ishin vetëm 10 persona. Për të gjithë të tjerët kishin krijuar një artificë si agjenci autonome dhe i nxirrnin jashtë shërbimit civil. Ne kërkuam unifikimin e strukturave, kemi bërë modele dhe u kemi dhënë udhëzim, kemi verifikuar disa nga bashkitë dhe kemi parë që kanë filluar t'i rishikojnë strukturat dhe më e rëndësishmja është të kërkojnë mendimin e Komisionerit para se të miratohet struktura. Pra, ne kemi arritur që njësitë e burimeve njerëzore të bindin kryetarët e bashkive të marrin miratim nga Komisioneri për strukturat. Megjithatë, mendoj që ligji për qeverisjen vendore duhet të vendosë standarde edhe në këtë drejtim.

Për sa i përket procesit të konkurrenive ose ajo çfarë pretendojnë njësitë e qeverisjes vendore, ne nuk mund t'i ndjekim në momentin që bëhen konkurrimet, pasi janë larg dhe stafi që ka në dispozicion Komisioneri është i përbërë nga 12 inspektorë, nga të cilët 4 janë nga Drejtoria Juridike. Nëse ne në DAP kemi një grup të gatshëm që ndjek të gjitha konkurrimet pranë ASPA-s, në njësitë e qeverisjes vendore ne shikojmë vetëm dokumentacionin dhe aty kemi konstatuar që ka pasur konkurrenive që nuk janë përmbyllur me konkurrues. Bashkitë e largëta pretendojnë se nuk ka persona që plotësojnë kriteret. Pra, nëse në VKM-të për konkurrimet kërkohet njëfarë standardi për vjetërsi në punë, e të tjera, në njësitë e qeverisjes vendore ka disa specifika, pasi ata funksionojnë edhe në bazë të ligjeve të posaçme, që nuk gjen persona që t'i përmbushin, ndaj mendoj se në rastet e qeverisjes vendore mbase duhet t'i ndajmë bashkitë edhe në kategori dhe të bëjmë edhe njëfarë lehtësimi për konkurrentët që do të rekrutohen. Kjo ishte ideja që ne kemi ngritur. Nëse e doni më të detajuar, mund të sjellim një material se si e mendojmë ne dhe cilat ligje duhen amenduar dhe duhen ndryshuar.

Për sa i përket nenit 66.1, kemi konstatuar raste. Unë nuk mund ta them sot emrin e ministrisë, sepse ne do të bëjmë një studim, por kur kemi shkuar për të bërë një ekzekutim vendim të formës së prerë, të cilën e kemi ekzekutuar, konstatuam se punonjëses i kishin ofruar 4 vende pune në nivel drejtori dhe nuk kishte pranuar. Ndërkohë, ata pretenduan se ajo ishte punësuar në një vend tjetër. Kur inspektorët e Komisionerit e ngritën si problem, brenda dy javësh, kam përshtypjen, Altin, ajo e pranoi vendin e punës që i kishin ofruar. Kemi raste konkrete. Megjithatë, tani që do të thërrasim të gjitha ministrinë në seancë dëgjimore, do t'i vlerësojmë të gjitha vendimet, sepse pranë ministrive apo çdo institucioni ngrihet një komision i posaçëm, i cili vlerëson kushtet, kriteret, pozicionet vakante dhe ofron vendet e punës.

A ka mundësi që DAP-i t'i verifikojë nëse janë të punësuar? Sigurisht që ka mundësi. Të gjithë personat që janë të punësuar paguajnë sigurime shoqërore. Ne i kemi dërguar shkresë dhe kemi marrë vërtetim nga Sigurimet Shoqërore që janë paguar nga ky muaj deri në këtë muaj nga filan institucion. Kjo është gjëja më e thjeshtë për t'u verifikuar. Këtë gjë do ta bëjmë tani që do e fillojmë fazën e dytë për vendimet gjyqësore. Pra, DAP-i nuk ka vakum ligjor, por duhet të bëhen shkresa dhe të presin për të marrë një përgjigje. Të paktën nuk mendoj se të gjithë që janë të pësuar, janë në administratë. Kjo është shumë e thjeshtë.

Për sa i përket personit përgjegjës, duhet të kemi parasysh se ligji për nëpunësin civil nuk lejon që Komisioneri të hetojë personat jashtë fushës së veprimit të këtij ligji. Kemi një rast të posaçëm. Nëse në ministri personi përgjegjës është sekretari i Përgjithshëm, që është nivel i lartë drejtues, pra është shërbim civil, në bashki nuk është ky pozicion, por emërimet do të nënshkruhen nga nënkryetari. Ky është një handikap i ligjit, por është një e drejtë e kryetarit, si një person i zgjedhur. Ne kemi konstatuar se burimet njerëzore kanë bërë materialet, kanë bërë vendimet, shkresat dhe ngecin te kryetari. Komisioneri nuk ka kompetencë të gjobisë kryetarin dhe këtu është artifica. Ne jemi munduar t'i bindim, kemi çuar shkresa dhe kemi ngritur problematika. Aktualisht i kemi bindur dhe po ekzekutohen. Pra, për këtë pjesë kemi thënë të sqarohet më saktë problemi i personit përgjegjës në kuptimin e ligjit, pasi e lënë përgjegjësinë te njëri-tjetri, bëri shkresën, por nuk u firmos, nuk u kalua e të tjera.

Për sa u përket disa momenteve, nëse mundet...

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Drejtori e bën shkresën dhe e çon, megjithatë ne kemi arritur që janë ekzekutuar, por, duke e pasur ...

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Unë po them se sot për sot nuk kemi hasur pengesë, që të na thotë dikush: nuk i ekzekutojmë.

Ne i çojmë, i verifikojmë në vend, përgatisim edhe materialet dhe modulet se si të veprojnë dhe duke qenë se kanë filluar procedurat, janë bërë konkurrimet, janë ndjekur, është njoftuar Komisioneri, neve na i sjellin të skanuar dokumentacionin nga inspektori përgjegjës dhe nuk kemi konstatuar refuzim, thjesht kemi parë që shtyhen afatet, por duke qëndruar ne pak konsekuent, janë përfunduar.

Për sa u përket akteve të Komisionerit, ato dalin *online* në faqen tonë zyrtare në momentin që nënshkruhen dhe janë të gjitha të detajuara. Ristrukturimi ka filluar në vitin 2017, ka filluar monitorimi, janë caktuar inspektorët përgjegjës, por duhet të keni parasysh se procesi i ristrukturimit është diskrecion i Komisionit të Ristrukturimit. Komisioneri nuk ndërhyt gjatë procesit të ristrukturimit, vëzhgon procedurat dhe në përfundim të procesit jep konkuzionet. Ne nuk mund të ndërhytë përgjatë ristrukturimit, sepse ndryshe nuk e bën komisioni ristrukturimin , por e bën Komisioneri. I thotë: çojë këtu apo këtu.

Për sa i përket përshkrimeve të punës dhe pse Komisioneri i quan parregullsi, parregullsi apo shkelje e ligjit, për ne është njësoj, është një terminologji që nuk mendoj se parregullsi nuk është shkelje e ligjit. Unë, si juriste, të paktën, e konceptoj njësoj. Nëse doni të themi se është shkelje e ligjit, dakord. Ne, përderisa themi se është gjendje paligjshmërie, raportet e monitorimit janë të njëjta me rekomandimet, është i njëjtë procesi i punës, janë të njëjta përgjegjësi të burimeve njerëzore dhe është i njëjti fenomen. Duke qenë DAP-i njësi përgjegjëse dhe ka përfaqësues në komisionet e ristrukturimit, detyrimisht është e njëjta procedurë, sepse është VKM-ja. Pra, rekomandimet janë të njëjta. Aty ku ka pasur problematikë më të madhe, e kemi konstatuar.

Nëse ne kemi verifikuar 50 personat që janë liruar nga shërbimi civil, janë të detajuara në raportet e monitorimit individual. Ne i kemi sjellë Kuvendit një përmbledhje me të gjitha problematikat. Kam përshtypjen se për çdo ministri është më vete shifra, por inspektorët, pas procesit të ristrukturimit, kanë verifikuar dhe kanë marrë strukturat. Si i kanë verifikuar strukturën e mëparshme dhe strukturën e tanishme nëse ka pozicione të lira?! Për personin e liruar nga shërbimi civil për shkak të ristrukturimit, kemi parë çfarë formimi arsimor ka. Nëse atje ka pasur pozicioni vakant si auditues dhe ai ka qenë me gjuhë-letërsi, automatikisht nuk ka ku shkon, sepse ka disa kërkesa për pozicionin e punës. Nuk i ka ndjekur, sepse të them të drejtën, nga ajo që ka bërë Drejtoria e Monitorimit, m'u krijua ideja që Komisioneri është jashtë loje. Duhet të kuptoni që kanë qenë të gjitha parregullsi në detaje, në çdo presje. Inspektorët tanë i dinë përmendësh të gjitha problematikat në çdo ministri. Atje ku procesi është bërë në rregull, jemi dakord.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit!

Ka pyetje të tjera?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Do të bëjë pyetje zoti Zeneli dhe do t'i japësh sërish përgjigje.

**Pranvera Strakosha** - Është keqkuptuar rasti i 105 kërkesave që janë të përfunduara. Në raport ka edhe një tabelë, ku thuhet: nga 105 kërkesa, të ardhura pranë Komisionerit, 12 kanë përfunduar me vendim për rregullimin e gjendjes së paligjshmërisë. Kjo do të thotë se është kërkuar që punonjësit t'i jepet e drejta që ka kërkuar. Në 5 raste ka pasur vendim për mbyllje të procedurës për shkaqe ligjore, pasi kemi konstatuar se, ndërkohë që ne administronim apo analizonim ankesën, subjektet dolën jashtë shërbimit civil. 13 raste janë bashkuar me mbikëqyrjen e përgjithshme, pra ka ardhur ankesa te Komisioneri, ndërkohë që ne kemi pasur inspektorët në terren, dhe kjo ankesë është trajtuar brenda raportit përfundimtar.

**Ulsi Manja** – Dakord.

**Pranvera Strakosha** – Jo, të lutem, në 6 raste...

**Ulsi Manja** – Dakord, të lutem, zonja Strakosha, se po i përsëritim gjërat.

**Pranvera Strakosha** – Jo, se thatë që janë ndarë të gjitha...

**Ulsi Manja** – Të lutem, shifra 105 është përmendur 8 herë nga ju, nga zoti Hyseni, nga zonja Hysi. Të lutem, të fokusohemi, se mund të kenë pyetje specifike kolegët.

Fjalën e ka kërkuar zoti Zeneli për pyetje.

**Alban Zeneli** – Faleminderit, zoti kryetar!

Normalisht, raporti i përgatitur nga Kuvendi është deri diku i plotë dhe ka evidentuar shumë problematika të shërbimit civil të vendit tonë. Ju e përmendët që ju kanë ardhur 105 ankesa, të cilat i keni shqyrtuar. Pyetja imë është kjo: në raport ju keni thënë se kanë ardhur raste të iniciuara nga media dhe nuk janë raportuar në raport, a keni ju një arsye specifike pse nuk është raportuar?

E dyta, sa është kostoja financiare e të gjitha evidencimeve tuaja të paligjshmërisë në shërbimin civil dhe a ka përgjegjës konkretë për këtë paligjshmëri që ndodh shumë shpesh në të gjitha institucionet e vendit tonë, sidomos në ristrukturimin e Kryeministrit, siç e keni cilësuar ju në raport?

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Zeneli!

Zonja Strakosha.

**Pranvera Strakosha** – Faleminderit!

Rastet për të cilat kemi marrë indicie nga mediet ishin emërimet e drejtuesve të dy agjencive, të cilat ishin shërbim civil dhe hynin te pesë raste, për të cilat unë thashë që kishte vendim për mbylljen e procedurës. Pra, ishte rasti i Afrim Qendros dhe një rast tjetër i AZHBR-

së: ata dolën jashtë shërbimit civil, ndërkohë që Komisioneri po hetonte emërimet e tyre. Në këto kushte, në kishim pengesë ligjore për të vazhduar hetimin e rastit. Këto ishin dy rastet e medias, kurse tri rastet e tjera janë ankesa që janë sjellë. Për të dyja emërimet që dolën në medie, në filluam inspektimin që të nesërmen, pra, po të shikoni momentin kur dolën në medie dhe momenti kur ne filluam inspektimin, është 24 orë. Ndërkohë, dolën jashtë shërbimit civil dhe ne e kemi mbyllur procesin për shkaqe ligjore.

Lidhur me koston financiare të paligjshmërive, në fakt këtë e shikon KLSH-ja, me shkeljet që vlerëson, por duhet kuptoni se, në qoftë se ne themi që janë emëruar në kundërshtim me ligjin, pa procedura konkurrimi dhe janë emëruar në një pozicion pune, këtu nuk konstatoj që ka dëm financiar, ka mospërbushje të ligjit në kushtet e rekrutimit. Kjo do të thotë se ai vend pune do të plotësohej nga një person dhe aty do të punonte një person. Pra, në qoftë se ne do të kishim dy persona të emëruar për të njëjtin vend pune, ose do të kishim dëm të ardhur direkt për institucionin, do ta kishim thënë. Në këtë rast kemi paligjshmëri në lidhje me zbatimin e ligjit dhe Komisioneri nuk ka të drejtë të gjobitë për një veprim që është bërë. Pra, nuk kemi kompetencë ligjore se do ta kishim bërë. Komisioneri nxjerr rekomandim dhe neni 15/2 thotë: “Në rastet kur vendimet paralajmëruese të Komisionerit nuk zbatohen, pra në rast se nuk do ta zbatojnë vendimin, atëherë Komisioneri e gjobit”. Pra, nuk konstaton direkt shkelje dhe e gjobit direkt, por për shkak të pengesës ligjore nuk mund të shprehemi në lidhje me atë që është bërë. Ne shprehemi në momentin kur vendimi paralajmërues i Komisionerit nuk zbatohet.

Pra, këtë na ka dhënë ligji, pra jemi të kufizuar në këtë drejtim. Në i lëmë një afat 15 ditë apo 1 muaj, varet nga problematika.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Strakosha!

A ka pyetje të tjera?

Po, zoti Lita e ka kërkuar fjalën për pyetje.

**Korab Lita** – Faleminderit, zoti kryetar!

Falënderoj edhe Komisionerin për raportin!

Kam një pyetje që lidhet me pushtetin lokal, sepse nga ajo fushë vij. Ka një handikap te kompetenca e kryetarit për të bërë emërimet, pasi ai është i votuar dhe në bazë të ligjit nuk e ka kompetencën për të bërë rekrutimet e punonjësve të administratës së bashkisë, ndërkohë me manovrat që bëjnë kryetarët përsëri shkon fjala e tyre. Në rastin konkret, bazuar në kontrolllet dhe në monitorimet që keni bërë kryesisht në pushtetin lokal, a keni ju një statistikë lidhur me

rekrutimet që bëhen nga pushteti lokal të tipit: emërohet me kontratë tremujore, pastaj bëhen procedurat e konkurrimit dhe gjithmonë fiton personi që ishte me kontratë? Besoj se ky model zotëron mbi 80% të rasteve të rekrutimeve në pushtetin lokal. Cili është reagimi i institucionit tuaj ndaj këtij fenomeni, pasi duhet të ketë një përgjegjës për të? Normalisht, ne e dimë të gjithë se kush është përgjegjësi. Plus pastaj që janë edhe kostot financiare, pasi ka raste që paguhen dy veta, njëri ikën, vendi mbetet bosh. Janë edhe justifikimet të tipit “jo nuk gjejmë specialistin”, pra janë shumë gjëra këtu.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Lita!

Po, zonja Strakosha, ju lutem, jepni shkurtimisht një përgjigje.

**Pranvera Strakosha** – Është e vërtetë që ndodh kështu. Ne i kemi fiksuar edhe në vendimet përfundimtare për ekzekutimin. Pra, mbase nuk janë 80% e rasteve, nuk mund të them një statistikë, por ka shumë raste kur ne kemi konstatuar dhe kemi thënë “Konstatimi i pavlefshmërisë absolute të aktit”. Janë bërë procedurat e konkurrimit dhe është emëruar i njëjti person, por nuk mendoj se arrin në masën 80%. Të them të drejtën, nuk kemi bërë ndonjë analizë, por mund të bëjmë një studim nisur nga vendimet që kemi nxjerrë. Do t’i shikojmë dhe do t’i bëjmë, sepse i kemi me emra të caktuar.

Për sa i përket personit përgjegjës, ju thashë që Komisioneri nuk ka kompetencë ligjore, vetëm në rast se nuk zbaton vendimet e tij, por ne nuk mund të dalim jashtë kornizës së ligjit, sepse pastaj kthehemi në gjendje paligjshmërie.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Strakosha!

A ka pyetje të tjera? Nuk ka.

A ka diskutime? Nuk ka.

Përpara se ta mbyll këtë seancë dëgjimore, dua të bëj disa konstatime lidhur me veprimtarinë e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2018. Përveç atyre që tha relatori, zoti Hyseni, i cili edhe drejton Nënkomisionin për Administratën Publike në Komisionin e Ligjeve. Ka ardhur koha që ne të kemi një hartë të nëpunësit civil. Kur flas për një hartë, aty duhet të përfshihen të gjitha institucionet ku janë nëpunësit civil qoftë në pushtetin qendror, në institucionet e varësisë, por edhe në pushtetin vendor. Pse jo paralelisht me këtë hartë të kemi edhe një hartë administrativo-gjyqësore. Kjo do të thotë se ju jeni instancë ankimi për vendimmarrjen e

Departamentit të Administratës Civile, por subjektet e cenuara nga kjo vendimmarrje mund t'i drejtohen drejtpërdrejt gjykatës.

Unë do t'i sugjeroj kolegut Hyseni të bëhet pjesë e rezolutës, që, në raportimin që ju do të bëni në mënyrë periodike, por edhe në raportimin që do të bëni vitin tjetër në Komisionin e Ligjeve, ta kemi të saktë edhe vendimmarrjen e Komisionerit, se edhe vendimet tuaja animohen në gjykatë.

Nuk ka rëndësi, po flas për prezumimin ligjor.

Të kemi pjesë të raportimit se sa subjekte të cenuara nga ndërmarrja e Departamentit të Administratës Publike i janë drejtuar Komisionerit, se sa i janë drejtuar drejtpërdrejt gjykatës, se cila ka qenë vendimmarrja e Komisionerit dhe se sa kjo vendimmarrje është ankimuar në gjykatë, që të kemi një hartë të këtij treguesi. Këtu del edhe lista e institucioneve që nuk zbatojnë, qoftë vendimet e gjykatës, qoftë vendimmarrjen e Komisionerit, por në fund del edhe dëmi ekonomik që pëson shteti nga kjo vendimmarrje, sepse në rast se largimi nga shërbimi civil është konsideruar i paligjshëm, qoftë në zbatim të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, qoftë edhe të një vendimi të Komisionerit, si dhe për atë vend pune paguhen njëkohësisht dy subjekte, patjetër që i duhet dhënë fund kësaj gjendjeje paligjshmërie. Nëse duhet ndërhyrë në nivelin e ligjit, do të ndërhyhet në nivelin e ligjit. Nëse duhet ndërhyrë në nivelin e Departamentit të Administratës Publike apo të institucioneve që nuk zbatojnë këto vendime, patjetër që shteti duhet të marrë masat përkatëse. Për këtë është shumë e nevojshme t'i kemi këta dy tregues në të ardhmen, hartën e nëpunësit civil, por edhe hartën administrativo-gjyqësore, në drejtim të vendimmarrjes, qoftë të departamentit, qoftë të Komisionerit.

E thashë edhe në mbledhjen që zhvilluam...

Zoti Shameti, mbarova. Besoj se nuk ka çështje më të rëndësishme se administrata publike. Të lutem!

Unë e thashë edhe në takimin që zhvilloi Kryetari i Kuvendit me institucionet kushtetuese të pavarura dhe ato të krijuara me ligj: jeni disa agjenci që merreni me mbikëqyrjen e ligjit të shërbimit civil. Është edhe Kontrolli i Lartë i Shtetit për një pjesë të mbikëqyrjes së ligjit për shërbimin civil, ndërsa ju jeni institucioni i drejtpërdrejtë. Është shumë i nevojshëm bashkëpunimi në rrafshin horizontal. Nuk kemi asgjë për të fshehur. Ligji e ka të përcaktuar qartë se kush janë nëpunësit civilë në çdo institucion. Kemi numrin, kemi institucionet, kemi edhe vendimmarrjet. Në fund kështu dalin përgjegjësitë. Kryetari i bashkisë, drejtuesi i institucionit qendror...

Ju thoni se nuk keni tagrin për të gjobitur, përveçse në rastet e moszbatimit të një vendimmarrjeje që merr Komisioneri. Nëse duhet të ndërhyhet në ligj, duhet një studim. Na e zgjidh gjënë, apo nuk na e zgjidh?

Unë bashkohem me shqetësimin që ngriti kolegu i opozitës, zoti Lita, që, kryetarët e bashkive, ndonëse drejtpërdrejt, nuk e kanë të drejtën të marrin njerëz në punë, sepse kanë drejtorin e burimeve njerëzore apo komisionin, kjo problematikë duhet... Kryetarët e bashkive gjithçka e lidhin me momentin e fitimit të zgjidhjeve. “Fitova zgjedhjet dhe kam të drejtën të ndryshoj 100% administratën,- thotë kryetari. -Është apo jo nëpunës civil, unë kam marrë votën e sovranit dhe do të ndërtoj administratën time.” Mirëpo edhe në pushtetin vendor, ligji për shërbimin civil ka futur kulturën e krijimit të memories institucionale. Do të duhen disa njerëz në pushtetin vendor, që janë memorie institucionale, se ofrojnë shërbime publike për qytetarët.

Na e zgjidh gjënë gjoba ndaj kryetarit të bashkisë, ndaj drejtorit të përgjithshëm, ndaj ministrit? Na duhet një studim.

Kam bindjen se gjoba e drejtpërdrejtë për personin që disponon firmën dhe vulën për shkarkimin apo largimin civil e një punonjësi, edhe mund të na e zgjidhë gjënë, se shqiptarë jemi. Shqiptari i thërret mendjes vetëm kur i cenohet xhepi.

Kështu që unë e shoh shumë të rëndësishëm rolin e institucionit tuaj në mbikëqyrjen e shërbimit civil.

Atë ditë, në vizitën studimore, kam ngritur edhe një shqetësim tjetër, pa dashur ta lidh këtë me situatën aktuale politike. Ju duhet të mbikëqyrni sa dhe si e zbatojnë vetë nëpunësit civilë ligjin nga e hëna në të premte, sepse partitë politike i lënë aktivitetet politike brenda orarit zyrtar. U vihet çelësi bashkive brenda orarit zyrtar dhe as roja i portës nuk është në institucion. Duhet të jetë pjesë e raportit se sa korrektë janë nëpunësit civilë në zbatimin e detyrimeve, që burojnë nga ligji për shërbimin civil, sepse ata duhet të jenë të parët që duhet të ndërgjegjësohen për ta zbatuar ligjin për shërbimin civil, pavarësisht mënyrës së rekrutimit.

Patjetër që kam konsiderata pozitive për punën e Komisionerit. Këto i thamë atë ditë edhe me kolegët e mi, që ishin pranë institucionit tuaj, por gjithmonë ka vend për përmirësime.

Nga ky raport i detajuar që keni sjellë ju, Shërbimet e Monitorimit, por edhe relatori, janë munduar të nxjerrin problematikat që meritojnë vëmendje, pse jo, të jenë pjesë edhe e fokusit të rezolutës që ne do të miratojmë në Kuvend, për qëllimin e mirë që kemi së bashku, për zbatimin me korrektësi të ligjit për shërbimin civil.

Komisioni ynë, si komision përgjegjës, është i hapur për plotësimin e nevojave buxhetore, por edhe të burimeve njerëzore, nëse do të duhen. Prandaj është e nevojshme që, në radhë të parë, ju t'ju nxirrni problematikat, që ne të kemi mundësi t'ju mbështesim.

Atë ditë kolegët kanë ngritur edhe shqetësime të tjera, që unë i konsideroj të drejta.

Cilat janë shqetësimet?

Një pyetje që ndoshta kërkon studim, është: a fitojnë përherë më të mirët në vendet vakante që shpall Departamenti i Administratës Publike dhe pushteti vendor?

Ne kemi marrë disa raporte periodike tuajat për gati 10 bashki, por duhet edhe fokusi i studimit dhe i analizës që do të bëjmë në këtë drejtim.

Ka një shqetësim. Hyhet në garë, ka një provim me shkrim, ka edhe një provim me gojë. Ndonëse ju nuk keni tagrin të ndërhyni në kompetencat e komisionit të testimit, procedurën keni të drejtë ta kontrolloni.

Duke ju falënderuar për punën, ju personalisht, por edhe stafin që drejtoni, këta që janë prezentë, por edhe ata që punojnë çdo ditë në institucionin tuaj, ju inkurajoj ta vazhdojmë bashkëpunimin dhe, pse jo, ta ngremë edhe në një nivel tjetër.

Pas jush, në ditët në vazhdim, do të vijë zëvendëskryeministri të raportojë për problemet e administratës, si dhe drejtoresha e Departamentit të Administratës Publike.

Në përfundim të të gjitha seancave dëgjimore dhe pas miratimit të rezolutave për 16 institucionet e varësisë së komisionit, ne, si komision, së bashku me nënkomisionet, do të ulemi dhe do të bëjmë një analizë se si do t'i ndërtojmë format e kontrollit parlamentar dhe të mbikëqyrjes parlamentare për zbatimin dhe respektimin e detyrave të lëna në rezolutat tona. Edhe këtë vit do të kemi një qasje krejtësisht tjetër për punën që bëni ju.

Ndërkohë, këshilltarët, relatori, por edhe kolegët me sugjerimet e tyre, të përgatisin projektrezolutën, të cilën do ta votojmë mbledhjen e ardhshme.

Shërbimi i Monitorimit të Kuvendit të bëjë gati projektrezolutën, që ta votojmë në mbledhjen tjetër dhe më pas ta çojmë në Kuvend!

Shumë faleminderit dhe ditë të mbarë!

## **MBYLLET MBLEDHJA**